



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura VIII
Sesioni pranveror

Komisioni për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti
Mbledhja nr. 138/2024
Prishtinë, më 2.7.2024, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Ferat Shala, kryetar, Jeta Statovci, zëvendëskryetare e parë, Fidan Jilta, zëvendëskryetare e dytë, Mimoza Kusari-Lila, Armend Muja, Driton Hyseni, Gramos Agusholli, Valentina Bunjaku - Rexhepi dhe Pal Lekaj anëtarë.

Mungoi: Abelard Tahiri, anëtar

I ftuar: Ymer Fejzullahu, Bordi i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë - ZRRE

Pjesëmarrës tjerë: Lutfije Dervishi, Gani Buçaj, Arta Isufi dhe Adnan Preniqi anëtarë të Bordit të ZRRE-së, Valdet Hadri, Muhamet Bytyçi dhe Ermira Llapashtica - Kuvend, Salih Hoxha – GP LVV, Ema Krasniqi – KDI, Egzon Dahsyla – Kallxo.com dhe mediat.

Stafi mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Muhamet Morina dhe Veton Raci.

Mbledhjen e kryesoi Ferat Shala, kryetar i Komisionit i ndihmuar nga Jeta Statovci, zëvendëskryetare e parë e Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur me datë 25.6.2024;
3. Votimi i Raportit vjetor të Performancës së Ndërmarrjeve Publike për vitin për vitin 2022;
4. Shqyrtimi i propozim-amendamenteve për Projektligjin nr.08/L-288 për Mbrojtjen e konsumatorit;
5. Shqyrtimi i “Kërkesës së deputetes Valentina Bunjaku – Rexhepi, lidhur me monitorimin e Autoritetit të Konkurrencës të Republikës së Kosovës, sa i përket zbatimit të Ligjit për zyrarët publikë”;
6. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Zyrës së Rregullatorit të Energji (ZRRE) për vitin për vitin 2023;
7. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Ndërmarrjes Publike të Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut – KOSTT Sh. A. për vitin 2023;
8. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen.

1. Miratimi i rendit të ditës

Jeta Statovci, kërkoj që të largohet pika 7, e rendit të ditës, sepse është futur në rend të ditës në kundërshtim me procedurën e përcaktuar me Rregulloren e Kuvendit të Kosovës. Ky material është në dispozicion vetëm tri ditë para se të mbahet mbledhja e Komisionit, po ashtu, sot kemi një rend dite të ngarkuar dhe mandej kemi vizitë në terren, për këto arsye propozoj që pika e 7 të hiqet nga rendi i ditës dhe të caktohet në njërin nga mbledhjet e radhës.

Kryetari, tha se bazuar në kompetencat e mia si kryetar i Komisionit, kam caktuar rendin e ditës dhe ai tha se ky raport është futur në rend dite edhe për faktin se një pjese të anëtareve të bordit të KOSTT-it ju përfundon mandati javën tjetër dhe unë nuk kam mundur të pajtohem që të ikë mandati i tyre pa raportuar në Kuvend. Ka pasur intenca që të konsumohet afati i një pjese të anëtareve të bordit, pa raportuar në Komision dhe unë nuk kam mundur të pajtohem më këtë fakt, andaj, edhe kam dashur që KOSTT të raportojë në lidhje me pretendimet për shkelje procedurale dhe ligjore lidhur me zhvillimet në KOSTT, sidomos në lidhje me dhënien e garancive milionëshe nga KOSTT-i për çështjen e investitorëve strategjikë, etj.

Jeta Statovci, tha se në si Komision kemi trajtuar të gjitha çështjet e hapura, por në lidhje me diskutimet tuaja, këto janë çështje të cilat i përkasin zhvillimeve të vitit 2024 dhe shqyrtimi i raportit të punës së KOSTT-it është për vitin 2023, andaj, kjo mund të rivendoset në rend dite në njërin nga mbledhjet e radhës.

Valentina Bunjaku – Rexhepi, tha se nga ana e KOSTT-it nuk është dashur të pritët dita e fundit për dorëzim të raportit të punës, ajo propozoi që kjo pikë të caktohet në rend ditë për ditën e enjte dhe të shqyrtohet ky raport pa i skaduar mandati një pjese të anëtareve të bordit.

Armend Muja, tha se duhet të marrim kohën e duhur për shqyrtim të raportit dhe të caktohen një mbledhje tjetër ku do të shqyrtohet ky raport.

Pal Lekaj, tha se është me rëndësi që raportimi i anëtareve të bordit të KOSTT-it duhet të ndodh brenda kohës në të cilën është bordi i kompletuar dhe të mos pritët përfundimi i afatit të mandatit të një pjese të tyre.

Pas diskutimeve, me gjashtë (6) vota Për, rëndi i ditës u miratua me propozimin për largimin e pikës 7, Shqyrtimi i Raportit vjetor të Ndërmarrjes Publike të Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut – KOSTT Sh. A. për vitin 2023.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur me datë 25.06.2024

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 25.06.2024, u miratua pa vërejtje.

3. Votimi i Raportit vjetor të Performancës së Ndërmarrjeve Publike për vitin për vitin 2022

Kryetari, theksoi se në mbledhjen e fundit e kemi shqyrtuar këtë raport, mirëpo, në mungesë kuorumi për vendimmarrje nuk është proceduar tutje.

Komisioni me gjashtë (6) vota Për, nxori këtë:

Rekomandim

- 1. Të miratohet raporti vjetor të Performancës së Ndërmarrjeve Publike për vitin 2022;*
- 2. Raporti i procedohet Kuvendit sipas procedurës.*

4. Shqyrtimi i propozim-amendamenteve për Projektligjin nr.08/L-288 për Mbrojtjen e konsumatorit;

Kryetari, tha se në bazë të nenit 76 të Rregullores së Kuvendit, e kemi në shqyrtim propozim-amendamentet për Projektligjin nr.08/L-288 për Mbrojtjen e konsumatorit, ia kaloj fjalën kryesuesit të grupit punues, z. Driton Hyseni, që ta paraqet para Komisionit, propozim-amendamentet.

Driton Hyseni, tha se për shkak të racionalizimit të kohës, propozoj që amendamentet të votohen në grup, për arsye se këto ndryshime nuk paraqesin ndonjë ndryshim substancial të ligjit. Po ashtu, ju informoj që grupi punues ka mbajtur dëgjim publik dhe takime pune ku kemi trajtuar ligjin nen për nen, andaj ftoj që projektligji se bashku me amendamente të votohen në grup.

Pas debatit, Komisioni me gjashtë (6) vota Për, nxori këtë:

Rekomandim

- 1. Të miratohet raporti me amendamente i Projektligjit nr.08/L-288 për Mbrojtjen e konsumatorit;*
- 2. Raporti procedohet tutje sipas procedurës.*

5. Shqyrtimi i “Kërkesës së deputetes Valentina Bunjaku – Rexhepi, lidhur me monitorimin e Autoritetit të Konkurrencës të Republikës së Kosovës, sa i përket zbatimit të Ligjit për zyrtarët publikë”

Kryetari, tha se në mbledhjen e fundit, kolegja znj. Bunjaku – Rexhepi, e ka bërë një kërkesë, të diskutohet në rend dite, mundësia e monitorimit për funksionimin e punës së nëpunësve publikë në Autoritetin e Konkurrencës së Kosovës. Ia kaloj fjalën propozueses të arsyetojë propozimin.

Valentina Bunjaku – Rexhepi, bazuar në diskutimet kur ishin në raportim Autoriteti i Konkurrencës, në lidhje me shfaqjen e disa parregullsive, kërkoj mbështetjen e kërkesës për monitorim të nëpunësve publikë në Autoritetin e Konkurrencës së Kosovës dhe për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës si vijon: duke kërkuar me shkrim nga KPMSHC-ja për monitorim urgjent nga ana e tyre, kërkoj mbështetjen tuaj që kjo kërkesë të bëhet bashkërisht nga Komisioni.

Armend Muja, tha se ka nevojë për qartësim se a bëhet fjalë për monitorim të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, nëse po, kjo është në fushën e këtij Komisioni, kurse nëse kërkesa është KPMSHC, atëherë kjo kërkesë duhet të shkoj përmes Komisionit për Administratë Publike. Këto kërkesa mund të shkojnë ndaras sepse kështu edhe funksionon.

Valentina Bunjaku – Rexhepi, tha se kërkesa është për monitorim të Ligjit për Mbrojtjen së Konkurrencës, për çka kërkoj mbështetjen tuaj, kurse në lidhje me KPMSHC-në, ne mund ta bëjmë si kërkesë që të shkojë përmes komisionit tjetër. Ne kemi të drejtë dhe kërkesa ime është që ky monitorim të del nga ky Komision.

Mimoza Kusari – Lila, tha se në mbledhjen kur ishin në raportim Autoriteti i Konkurrencës, kishte një debat me shkarje të mëdha dhe ka pasur deklarime apo kategorizime, të cilat nuk i bëjnë nderë retorikes së punës në Komision, sidoqoftë në lidhje me kërkesën e koleges Bunjaku, në situatën kur gjashtë (6) deputetë kanë të drejtë të kërkojnë mbikëqyrje të zbatimit të ligjit, kjo mund të bëhet edhe nga grupi parlamentar të cilit i takon. Në këto rrethana, ne nuk mund t'i bashkëngjitemi kërkesës tuaj, në lidhje me vlerësimin e mbikëqyrjes së Autoritetit të Konkurrencës, gjithmonë, qoftë në raportim, qoftë në trajtim të vendimeve etj., në aspektin përmbajtësor, kurse në aspektin e çështjeve të zbatimit të Ligjit për nëpunës publikë që është përgjegjës KPMSHC, kjo është çështje tjetër të cilës ne nuk mundemi me iu bashkëngjiti.

Valentina Bunjaku – Rexhepi, në lidhje me performancën dhe problemeve të tjera, kërkova monitorimin e atij institucioni, nëse dëshironi që ajo agjenci të performojë mirë, duhet të bëhet monitorimi, përtej kësaj ne, kemi të drejtë për një monitorim të tillë. Sa i përket të drejtës time që kjo kërkesë të shkoj përmes grupit parlamentar, nuk dua ta politizoj këtë çështje, prandaj kërkova mbështetjen e Komisionit.

Jeta Statovci, tha se në bazë të e-mailit, shohim se kolegja veç i është drejtuar KPMSHC-së në kuadër të kompetencave të saj si deputete, kjo është një çështje specifike dhe nuk ndërlidhet me tërësinë e ligjit për mbrojtjen e konkurrencës. Monitorimi i ligjit bëhet kur kemi problem me zbatimin e ndonjë dispozite ligjore, dhe këtë as nuk e kemi në plan të punës së Komisionit apo nuk kemi ndonjë adresim që ka probleme me zbatim të ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

Pal Lekaj, tha se monitorimi i ligjit nuk ka arsye të mos përkrahet, ligjet mund të monitorohen dhe në baze të gjeturave mund të amendamentohet dhe nuk e kuptoj pse koleget në këtë Komision nuk e përkrahin një kërkesë të tillë.

Armend Muja, tha se në lidhje me kërkesën e deputetes, ka të bëjë me kërkesën ndaj KPMSHC për monitorim të procedurave të zbatimit të Ligjit për Shërbim Civil, çështja është monitorimi i zbatimit të Ligjit për Shërbyesit Civilë, dhe kjo duhet të jetë në kuadër të Komisionit tjetër funksional.

Driton Hyseni, kërkoj që kjo çështje mund të shqyrtohet dhe të futet në planin e punës në sesionin vjeshtor sepse tanimë jemi në fund të sesionit pranveror.

Kryetari, tha nëse ligjërisht nëse shohim se ka ndonjë shkelje të ndonjë dispozite ligjore edhe në rastet kur kjo nuk bie në domenin e Komisionit tonë, kjo mund të adresohet përmes Komisionit funksional që mbulon fushën e caktuar.

Pas debatit, me dy (2) vota Për dhe pesë (5) vota Abstenim, Komisioni nuk e përkrahu propozimin e deputetes Bunjaku – Rexhepi.

6. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) për vitin për vitin 2023

Kryetari, tha se në bazë të nenit 10 paragrafi 1, të Ligjit nr.05/L-084, për Rregullatorin e Energjisë, kryesuesi i Bordit të ZRRE-së i dërgon Kuvendit raportin vjetor, jo më vonë se 3 (tre) muaj pas përfundimit të vitit kalendarik. Raportin e kemi pranuar. Nga stafi e keni marrë një Memo më të cilin keni një analizë dhe disa pyetje lidhur me këtë raport vjetor. E uroj z. Fejzullahu, që në takimin e Bordit Rregullativ të Komunitetit të Energjisë (ECRB), të mbajtur në Athinë, është zgjedhur i këtij organi të rëndësishëm ndërkombëtar. Për ta prezantuar raportin ia kaloj fjalën kryesuesit të bordit z. Ymer Fejzullahu dhe mandej hapim debat.

Ymer Fejzullahu, kryesues i Bordit të ZRRE-së, falënderoi kryetarin për urimet, ai shtoi se ECRB është organi i pavarur rajonal i Rregullatorëve të Energjisë në Komunitetin e Energjisë, dhe drejtohet nga Bordi i përfaqësuesve të nivelit të lartë nga agjencitë kombëtare rregullatorë të energjisë të palëve kontraktuese, vëzhguesve dhe pjesëmarrësve të Komunitetit të Energjisë. Mandati i ynë si President i ECRB është në kohëzgjatje prej dy vitesh. Po ashtu, ai njoftoj se përveç zgjedhjes në krye të ECRB, lajm i mirë është edhe vlerësimi i Sekretariatit të Energjisë me seli në Vjenë, për ZRRE-në në menaxhimin e krizës së energjisë është vlerësuar me me 10 pikë përqindje më shumë se vitin paraprak. Ai njoftoi po ashtu, se në janar të këtij viti është zgjedhur kryesues i grupit implementues për market kapling, ky është një projekt i financuar nga USAID-i.

Lutfije Dervishi, anëtare e Bordit të ZRRE, në emër të Bordit të ZRRE-së paraqes raportin vjetor, ku tha se pjesë e këtij raporti është edhe raporti financiar i buxhetit të Rregullatorit për vitin 2023. Vlen të theksohet se Viti 2023 është shënuar me arritje të lartë të punës profesionale të ZRRE-së, dhe kjo është evidentuar edhe në Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë në Raportin e tyre Vjetor të Zbatimit për vitin 2023. Vitin e kaluar ZRRE-ja ka mbajtur një mbledhje të përbashkët me Entin Rregullator të Shqipërisë dhe përmes një vendimi, ka emëruar ALPEX-in Operator të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO). Në vazhdimësi të këtyre proceseve, kryesuesit e Rregullatorëve të Kosovës, Shqipërisë, Maqedonisë së Veriut dhe Greqisë, e po ashtu, edhe kryeshefat e OST-të dhe Bursave të Energjisë Elektrike të këtyre vendeve, kanë nënshkruar Memorandumin e Mirëkuptimit lidhur me projektin e Bashkimit të Tregjeve.

Sa i përket aktiviteteve të brendshme, Bordi i ZRRE-së në vitin 2023 ka mbajtur 14 mbledhje publike, në të cilat janë marrë 169 vendime. Këto vendime kanë të bëjnë me: aprovimin e rregullave, metodologjive dhe dokumenteve tjera të sektorit të energjisë dhe ndër to vlen të cekem: Rregulla për Përgatitjen dhe Vlerësimin e Planeve Zhvillimore dhe Investive, Rregulla për vet – konsumatorët, Metodologjia për Përcaktimin e Çmimit Maksimal, Rregullat e tregut dhe Modeli i Tregut të Energjisë Elektrike.

Gjatë vitit 2023, Rregullatori ka vazhduar monitorimin për ndërmarrjet e licencuara të energjisë dhe përderisa një vit me herët kishte dhënë gjobë për ndërmarrjet KEDS dhe KESCO, këtë vit ka dhënë gjoba për ndërmarrjet KEK dhe KOSTT. Po ashtu, ZRRE-ja e ka përfaqësuar zyrën në gjykata, në lidhje me këto vendime sepse të gjobiturit kanë refuzuar për të paguar gjobat, mirëpo është rezultuar se ankesat e palëve duhet të jenë te ekzekutueshme. Ne fushën e Licencimit dhe Autorizimit të aktiviteteve të energjisë, ZRRE ka Lëshuar shtatë licenca për Furnizim me shumicë të energjisë elektrike, tri licenca për furnizim me energji elektrike, ka vazhduar dy licenca, ka lëshuar autorizimin e tetë shoqërive me kapacitet rreth 173MW, ka refuzuar autorizimin e një shoqëri dhe ka dhënë 66 autorizime për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë konsum. Tri nga licencat e lartpërmendura i ka njohur në bazë të parimit të reciprocitetit.

Sa i përket Mbrojtjes së konsumatorëve, Rregullatori ka zgjidhur 199 ankesa të konsumatorëve, ku 140 prej tyre janë vendosur në favor të konsumatorëve, ndërsa 59 ankesa të konsumatorëve janë refuzuar si të pabaza, Ndërsa, Bordi i ZRRE-së i ka trajtuar edhe 34 ankesa të konsumatorëve. Po ashtu, sa i përket kontesteve mes palëve për jo balance, ZRRE-ja merr vendim që KESCO t'i paguaj KOSTT-it faturat për jo balancë në vlerë prej 11,1 milion € dhe që KEDS t'i paguaj KOSTT-it faturat për jo balanca në vlerë prej 3,7milion €. Në vazhdimësi, ZRRE-ja ka vazhduar me aprovimin e dokumenteve sipas legjislacionit për operatorët OST e OSSH të energjisë dhe ka aprovuar planet zhvillimore 10 vjeçare dhe 5 vjeçare, planin investiv njëvjeçar të OSSH dhe planin e humbjeve, bilancet, derogimin e dispozitave, vendosjen e obligimit të FSHU, etj. Në vitin 2023, ZRRE-ja ka realizuar të hyra në shumë prej 7,6 milion €. Shuma totale e buxhetit të shpenzuar nga ZRRE-ja në vitin 2023 është 680 mije euro dhe pjesa prej 6.9 milion euro është derdhur në Buxhetin e Republikës së Kosovës sipas legjislacionit. Realizimi i brendshëm i buxhetit për ZRRE-në në 2023 me atë të parashikuar është 97.72%.

Sa i përket funksionimit të Sektorit të Energjisë për vitin 2023, kërkesa e përgjithshme për energji elektrike në sistem në vitin 2023, ka pasur një ngritje për 2.26%, në krahasim me vitin paraprak d.m.th. ka qenë 6,695 GWh. Prodhimi i gjithmbarshëm i energjisë elektrike në vitin 2023 ka qenë 5,698 GWh, prej të cilave 86.5% janë nga termocentralet, dhe 13.5% nga HC dhe BRE tjera janë, dhe pjesa prej 1248 MWh për të mbuluar kërkesën e përgjithshme është mbuluar me import. Për vitin 2023, ZRRE-ja ka lejuar të hyra prej 398 milionë euro për ndërmarrjet e parregulluara të energjisë elektrike dhe 10.4 milionë euro për ndërmarrjet e energjisë termike. Lidhur me performancën e operatorëve, vlen të theksohet se humbjet në transmetim janë në nivel të pranueshëm, e po ashtu, në OSSh në vitin 2023 ka pasur zvogëlim të humbjeve 1.5% përqindje krahasuar me vitin 2022.

Gjatë vitit 2023, çmimet e realizuara mesatare kanë qenë më të ulëta se të lejuara nga ZRRE-ja, por sasia e blerjeve të energjisë ka qenë dukshëm më madhe se sasia e lejuara nga ZRRE-ja, ku për shkak të vjetërsisë së njësive, KEK-u ka pasur rënie të paplanifikuar dhe remonteve të tyre. Çmimet e energjisë elektrike të tregtuara në tregun e ditës në avancë në bursat HUPX/HUDEX edhe pse janë zbritur në raport me vitin 2022, prapë janë të larta për vendin tonë, ku brezi i çmimeve mesatare për vitin 2023 rezultoi të jetë 130-135€/MWh. Inflacioni për Eurozonë – Në vitin 2023 kishte shënuar rënie nga viti 2022, përkatësisht nga 8.39%, në 5.4%, prandaj këta indikatorë kane pasur efekt në përditësimin/azhurnimin e të hyrave të operatorëve të rregulluar këtë vit, ku është rezultuar me zbritje të tarifave. Për kategorinë e konsumatorëve familjarë, çmimi mesatar i energjisë në vitin 2023 ishte 7.12 €cent/kWh, ndërsa për konsumatorët jofamiljarë, çmimi mesatar i energjisë është 9.27 €cent/kWh. Sipas burimeve të dhënave nga

Eurostat, Kosova vazhdon të jetë vendi me çmimin më të ultë të energjisë elektrike në rajon dhe në Evropë.

Rregullatori vazhdon të bashkëpunojë ngushtë me komisionet parlamentare të Kuvendit, me ministritë përkatëse, Autoritetin e konkurrencës, Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë, Asociacionin rajonal të rregullatorëve, Këshillin e rregullatorëve, e në baza të rregullta, përveç këtyre ka kontaktet – takimet-komunikimet edhe me konsulentët ESA, Tetrattech, USAID, të cilët e kanë ndihmuar shumë ZRRE-në, sidomos në mungesë të stafit, prandaj me ndihmën e tyre kemi realizuar 95% të punëve të planifikuara. Duke pasur parasysh një performancë të suksesshme nga këndvështrimi i Rregullatorit, kërkojmë aprovimin e raportit vjetor për vitin 2023.

Kryetari, tha në lidhje me konstatimet tuaja se Kosova ka çmimin më të ulët të energjisë, në kuadër të kësaj a e trajtoni edhe çështjen e subvencioneve të cilat me mjetet e taksapaguesve janë dhëne, sa është vlera e mjeteve nga buxheti i shtetit me të cilat është subvencionuar sektori i energjisë. Po ashtu, ai kërkoi informacione në lidhje me jo balancat e KOSTT-it me Ujmanin, ai kërkoi një raport me shkrim në lidhje me këtë çështje. Kryesuesi kërkoi informacione rreth involvimit të ZRRE-së rreth Parkut të energjisë solare, a mund të me thoni mendimin tuaj rreth veprimit të KOSTT-it, të cilët kanë ndarë rreth 6.7 milion euro letër garanci për këtë projekt, në fakt e ka parapaguar energjinë e blerë dhe a ka marrë konfirmim nga ju KOSTT-i për këtë blerje të energjisë nga ana e KOSTT-it, a janë ndjekur procedurat e rregullta për këtë veprim dhe cili është qëndrimi i juaj në lidhje me këtë letër garanci dhe a ndikon në çmimin fundor kjo letër garanc nga ana e KOSTT-it.

Ymer Fejzullahu, kryesues i bordit të ZREE-së, tha se në lidhje me e subvencionet e Qeverisë në çmimin e energjisë elektrike, duhet të theksohet se ka pasur efekt pozitiv, ne e kemi kaluar me pasoja minimale krizën e energjisë elektrike dhe implementimi i bllok tarifës është treguar shumë i suksesshëm. Në këto çmime përfshihet edhe subvencionimi i energjisë nga ana e Qeverisë, subvencioni i para është në vlerë prej 100 milionë euro, por duhet ta theksojmë edhe shtetet në rajon kane pasur subvencionime të energjisë dhe atë shumë me shumë se sa subvencionimi i energjisë nga ana e shtetit tonë. Në lidhje me kontestet të cilat janë ngritur nga cilado palë, ne si ZRRE e kemi shqyrtuar sipas rregullit të zgjidhjes së kontesteve. Kemi pasur dy konteste, vlera e tyre ka qene rreth 11 milionë euro, njëri kontest ka qenë në mes të KEDS-it dhe KOSTT-it, dhe kontesti në mes të KEK-ut dhe KOSTT-it. Të dy këto konteste janë zgjidhur nga ana jone dhe i është dhënë e drejtë pjesës e cila ka pasur argumente. Në lidhje me Ujmanin, ne kemi hartuar një draftraport të cilin ia kemi dërguar Ujmanit, jemi duke prit përgjigje dhe ne momentin që i kemi të plota informacionet, do t'i përcjellim edhe tek Komisioni juaj. Në lidhje me garancinë e KOSTT, ne si ZRRE nuk kemi asnjë obligim në raport me këtë garancinë dhe ne nuk kemi ende asnjë kërkesë për njohje në shpenzim dhe kurdo që të vije tek ne, do ta trajtojmë sipas rregullave në fuqi.

Me kërkesë të tij, **Jeta Statovci zëvendëskryetare e parë**, e zëvendësoi kryetarin në kryesimin e mbledhjes dhe fjalën ia kaloi deputetit Pal Lekaj.

Pal Lekaj, kërkoi informacione rreth asaj se a ka kërkesa të prodhimit të energjisë alternative nga era, nga uji apo biomasa etj., nëse nuk ka kërkesa të tilla, a është problemi tek korniza ligjore apo ku qëndron problemi, ai pyeti edhe për procesin e licencimit të kompanive, kemi kompani të

cilat kane aplikuar për licencim që nga viti 2019 dhe ende nuk janë licencuar, ku qëndron problemi, a ka ndonjë afat për licencim të tyre. Lekaj pyeti rreth monitorimit të funksionimit të KEK-ut dhe KEDS-it, shoh se keni dënuar KEK-un rreth 3 milion euro, po ashtu, ka një gjobë edhe për KEDS, pse ka ndodh kjo gjobitje e tyre. Ai kërkoi më shumë informacione rreth punimeve të KEDS-it, ku tha se edhe në këtë kohë vere ku temperaturat janë shumë të larta, KEDS-i po paralajmëron punime në rrjet, çka po ndodh? Në raport e keni përmendur se konsumatorët mund të aplikojnë për furnizim nga tregu i lirë i energjisë elektrike, a kemi ndonjë rast të tillë ku konsumatorët kane aplikuar për furnizim nga tregu i lirë?

Ymer Fejzullahu, kryesues i Bordit të ZREE-së, tha në lidhje me energjinë alternative, projekti me i madh ka qenë 150 megavat me solare në qytetin e Gjakovës, kemi edhe autorizime të cilat janë më të vogla, ku nga janari deri me tani, kalohet mbi 7 megavat autorizime për konsumatorë të vegjël. Në lidhje me autorizimet nga viti 2019, në asnjë rast nuk ka ndodh që për fajin e ZRRE-së të mos lëshohen licenca, kjo varet edhe nga institucionet tjetra dhe në lidhje me aplikimet të cilat janë në procedurë, ne presim kompletimin e dokumentacionit dhe kurdo që kemi dokumentacion të rregullt, ne si ZRRE do të nxjerrim vendime meritore. Në lidhje me gjobat që i cekët, ato janë shqiptuar konform legjislacionit në fuqi dhe në përputhje me përgjegjësitë tona. Në lidhje me ndërprerjet, në rrjetin e shpërndarjes kemi investime të cilat janë lejuar nga ana e ZRRE-së dhe fal këtyre investime kemi rrjet të mirë dhe këto investime janë rreth 20 milionë euro dhe ndërprerjet po monitorohen, mirëpo, kapacitetet e OSHC-së nuk janë të mjaftueshme dhe po punohet që të mos ketë ndërprerje të energjisë elektrike gjatë periudhës së dimrit. Në lidhje me tregun e lirë, kemi mbi 15 të licencuar, mirëpo, për shkak të çmimeve, asnjë prej konsumatorëve nuk kanë interes të furnizohen me ato çmime.

Pal Lekaj, në lidhje me procesin e licencimit, Conture Glogal dihet se ka fituar rreth 20 milionë euro në arbitrazh, kemi prapë ndonjë kërkesë në arbitrazh apo si është puna?

Ymer Fejzullahu, kryesues i Bordit të ZREE-së, tha, se me sa kemi informata, në ZRRE, ende nuk ka një kërkesë të tillë.

Kryetari, ia kaloi fjalën deputetit Driton Hyseni.

Driton Hyseni, tha se në raportin e vitit 2023, Conture Global ende figuron në procesin e licencimit dhe mendoj se kjo kompani veç ka marrë një përgjigje dhe kjo duhet të ceket në raportin e vitit 2024. Në lidhje me aplikimin për të marrë autorizime për vetë gjenerim, në raport thuhet se janë 66 autorizime të lëshuara me panele solare, a janë implementuar këto projekte dhe a ka ende kërkesa të cilat janë në proces për licencim, po ashtu, në lidhje me rritjen e numrit të operatorëve në tregun e energjisë, ne kemi 8 të licencuar në vitin 2022 dhe 2023, ne kemi vetëm KESCO-që të ofrojë shërbime në raport me konsumatorin fundor, në vitet në vijim, a do të kemi ndonjë licencim të ndonjë operatori, i cili do të mund të bëjë furnizim të konsumatorit fundor.

Ymer Fejzullahu, kryesues i Bordit të ZREE-së, tha se vetëm dje kemi lëshuar 85 – 90 autorizime për konsumatorë, falë edhe subvencioneve të qeverise kemi kërkesa të larta për zvogëlim të faturës përmes paneleve solare, por edhe çmimi i paneleve solare në treg, aktualisht është i volitshëm dhe kjo ndikon në kërkesën për licencim të përdorimit të energjisë vetë gjeneruese. Sa i përket furnizuesve të rinj, KESCO, ka obligim që e kemi vendos në shërbim

universal, ku secili konsumatorë shtëpiak dhe të vegjël e ka atë të drejtë që i garantohet. Nga shkurti edhe bursa është funksionalizuar dhe kjo i mundëson konsumatorëve që të lidhin kontratë duke ju referuar çmimeve të bursës, ky është lehtësim për konsumatorët dhe furnizuesve. Brenda dy viteve po bëjmë përpjekje të bashkimit të tregjeve me Maqedoninë e Veriut dhe me Greqinë dhe kjo do të jetë po ashtu, një lehtësim tjetër për konsumatorët. Sa i përket furnizimit, ka furnizues të interesuar dhe po shpresojmë që në vitin e ardhshëm të nënshkruajmë memorandum bashkëpunimi edhe me Malin e Zi dhe furnizues edhe nga Mali i Zi. Po shpresojmë që në të ardhmen nuk do të kemi nevojë për nënshkrim të memorandumeve individuale me shtete, por kjo të mund të bëhet përmes një marrëveshje.

Armend Muja, në lidhje me prodhimin e energjisë, në raport ofroni të dhëna mujore për prodhimin e energjisë, por më shumë relevante janë raporte vjetore, ajo që shoh në raport është se në vitin 2023 kemi një rënie të prodhimit të energjisë, kjo për shkak të prodhimit më të vogël të energjisë elektrike me thëngjill, si shkak që KEK-u ka qenë në remont B1 ose B2, sa i përket energjisë se ripërtëritshme, në raport ceket që energjia e ripërtëritshme ka arrit në 708 Gigavat, apo 11% në raport me gjithë prodhimin e energjisë, ky është një trend në rritje i prodhimit të energjisë së ripërtëritshme. Energjia e prodhuar dhe energjia e konsumuar, del që ne kërkesa për energji po e tejkalon prodhimin dhe për pasojë kemi nevojë për import. Çfarë ndikimi ka pasur ristrukturimi i tarifave, menjëherë pas ristrukturimi ka rënë konsumi i amvisërive, dhe për këtë ai kërkoi një raport të detajuar rreth ristrukturimit. Sa i përket konsumit sipas brezave, në brezin e parë janë 322 mijë konsumatorë, apo rreth 54% e të gjithë konsumatorëve, por shpenzimi i tyre i energjisë është 34%, a ka kuptim kjo, kurse pjesa tjetër e cila është mbi këtë brez e shpenzojnë afërisht rreth 67% të energjisë, për këtë na duhet një analizë e qartë. Po ashtu, tek humbjet e energjisë, ju keni thënë se qofshin ato humbje komerciale apo teknike, në vitin 2023, janë diku 20% apo 2% më pak se sa viti paraprak, humbjet në OSSH nga viti 2013 kane qenë 35% sepse ai është viti i privatizimit, deri në vitin 2023, këto humbje kanë arrit në 20% apo janë ulur për 15%, ato janë ulë kryesisht tek humbjet komerciale, por tek humbjet teknike ka pas një ulje shumë të vogël, ai pyeti rreth shpenzimeve të lejuara për OSSH në rrjetin elektrik që nga viti 2013. Parashikimet kanë qenë që deri në fund të vitit 2023, humbjet komerciale dhe teknike bashkërisht do të jenë 622 Gigavat, kurse parashikimet e ZRRE-se kanë qenë më ndryshe, si përfundim caqet e vitit 2010 nuk janë mbërrir, ai pyeti sa e ka pasur të lejuar humbjen në rregullimin tarifor dhe sa e ka të realizuar. Tek humbjet e energjisë, ka dallime në distrikte, cila është arsyeja që distrikti i Pejës dhe Gjakovës ka më shumë humbje komerciale dhe teknike me rreth 30%. Në lidhje me qarkullimin dhe të ardhura 10 vjeçare të KESCO dhe KEDS, ata i kanë të lejuara 404 milionë euro, 90% e faturimit është arkëtua dhe e ka mbi diku mbi 380 milionë euro, kur shohim qarkullimin e tyre në bazë të dhënave të ATK-së, shohim 560 milionë euro qarkullim, kah ka ardhur qarkullimi i tyre në këto vlera, e njëjta vlen edhe për KEDS-in. Njëjtë ndodh edhe me KOSTT-in, cilat mund të jenë të hyrat tjera të tyre që cilat janë mbi vlerën e lejuar, pse ndodh kjo diferencë.

Sa i përket devijimeve nga sistemi, del që në vitin 2023 ka një zvogëlim të ndjeshëm, në lidhje me borxhin e keq, ai paralajmëroi se do të shtrojë pyetje me shkrim.

Ymer Fejzullahu, kryesues i Bordit të ZREE-së, tha se në lidhje me prodhimin, kemi pasur më pak se sa në vitin paraprak, mirëpo ne konsiderojmë se është i arsyeshëm për faktin se kemi pasur stabilitet me energji elektrike nga gjeneratorët vendorë gjatë kësaj periudhe për shkak të remonteve apo investimeve në KEK, të cilat konsiderojmë se e kanë rritur sigurinë e investimit

me energji elektrike, sidomos në periudhën e dimrit. Në lidhje me burimet e ripërtritshme, detyrimet në raport me sekretariatit, e kemi në total konsumimin, por jo detyrimisht me raport me prodhimin, deri në vitin 2023 e kemi rreth 32%, ku 18% mbulohet nga druri, i cili përdoret për zjarr në zonat rurale, rreth 6% është prodhim nga energjia e ripërtritshme, trendi është që të arrihet synimi i 2030-ës. Në lidhje me të dhënat nga brezi, rreth 70% e konsumatorëve i përkasin brezit të shfrytëzimit të energjisë deri në 800 megavat, por këtë çështje do ta rishikojmë prapë. Në lidhje me investimet në OSSH, përafërsisht në çdo 5 vjeçar i kemi lejuar diku 100 milionë euro, në 5 vjeçarin e dytë me disa projekte emergjente, janë lejuara diku rreth 130 milionë euro, ZRRE-ja ndëshkon në fund të çdo viti tarifor mosrealizimin e investimeve të lejuara. Ne kemi kërkuar auditim të brendshëm 10 vjeçar dhe të shohim të gjitha bilanci. Humbjet e lejuara janë të përfshira me gjithë humbjet në veri, në vitin e kaluar humbjet teknik dhe komerciale janë 15.8%, çdo mosrealizim i trageteve është kosto që mbulohet nga ana e OSSH-së dhe jo nga konsumatori, nëse e shihni në 2 vitet e kaluara për shkak të mosrealizimit të trageteve dhe për shkak të devijimeve në sistem OSSH-ja ka pasur 20 milionë euro humbje dhe 16 milionë euro kosto shtesë. Sa i përket humbjeve nëpër distrikte, për dallimet e humbjeve nuk kemi studim konkret, por në bazë të dhënave nga e kaluara, ta zëmë si shembull distriktin e Mitrovicës, përveç pjesës veriore, ka ndikuar edhe shkalla me e lartë e vjedhjeve dhe mos efikasiteti i gjykatave.

Kryetari, tha se distrikti i Pejës ka pozicion gjeografik më specifik sesa vendet tjera dhe cilësimet se në atë rreth ka vjedhje më shumë, është mirë ta analizohen më mirë sepse qasja siç është zona turistike e Rugovës mund të ndryshojë këto të dhëna, andaj duhet të jemi më të kujdesshëm kur nuk i kemi të dhënat e sakta.

Ymer Fejzullahu, kryesues i Bordit të ZREE, tha sa i përket çështjes të hyrave, KESCO i ka të hyrat e rregulluara dhe të parregulluara, të hyrat e rregulluara përcaktohen nga ana e ZRRE-së, shumë pak, ka të hyra të parregulluara, por ajo varion nga konsumatorët e mëdhenj. Te KEDS-i mund t'i lejohen shembull në vitin vijues 127 milionë euro, mirëpo, meqenëse ka pasur edhe nga 10 ose 15 milionë euro nga viti i kaluar dhe kjo korrigjohet në vitin e ardhshëm, të hyrat e parregulluara në KEDS, nuk e tejkalojnë vlerën prej 10 milionë euro. Një ndryshim tjetër mund të jetë norma e ndryshme e zhvlerësimit, po ashtu, KEDS dhe të gjitha ndërmarrjet kanë 3 lloje të pasqyrave, pasqyrat rregullative, pasqyrat sipas raportimit standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar dhe pasqyrat për çështje të ATK-së. Në lidhje me borxhin e keq, këtë vit kemi filluar ta trajtojmë borxhin e keq edhe ndaj KESCO-s, nga 3.4% është ulur në 2.27% në procesin tarifor. Ai njoftoi po ashtu, që janë 10 pozita të lira por të cilat nuk plotësohen sepse nuk ka interesim për shkak të pagës që ofrohet, kemi 4 zyrtarë që e kanë lëshuar ZRRE-në dhe kjo paraqet shqetësim për funksionimin tonë.

Jeta Statovci, theksoi se krahasuar me tabelat, shohim se niveli i prodhimit ka mbetur relativisht i ngjashëm, mirëpo, tek çështja e importit kemi një lloj përgjysmimi i importit, çka ka ndikuar që të jetë kjo ulje e importit?

Ymer Fejzullahu, kryesues i Bordit të ZREE-së, tha se një nga efektet kryesore që ka ndikuar në rënien e importit, mund të jetë reduktimi i humbjeve.

Jeta Statovci, pyeti rreth procedurave të licencimit mbi 5 megavat dhe nën 5 megavat, shohim se për licencat nën 5 megavat janë vetëm 4 licenca. A bëni ndonjëherë ndonjë kontroll se sa ka kërkesa të deponuara dhe sa ka autorizime të lëshuara sepse ka ankesa se ka vonesa në dhënien e autorizimeve?

Ymer Fejzullahu, kryesues i Bordit të ZREE-së, tha se çdo vit, kur bëhen planet 10 vjeçare, një prej komponentëve është edhe përkrahja e burimeve të ripërtritshme të energjisë, për shkak të gjendjes ekzistuese të rritit, OSSH ende nuk është në gjendje të inkorporoj nivelin e kënaqshëm të burimeve të ripërtritshme, por niveli është i kënaqshëm.

Jeta Statovci, pyeti rreth tarifës së rikyçjes, a aprovon ZRRE-ja këto tarifa dhe a bëni kategorizim në bazë të gjendjes ekonomike të faljeve apo është tarifë e përgjithshme?

Ymer Fejzullahu, kryesues i Bordit të ZREE-së, tha se shkyçjet ndodhin me paralajmërim, në shumicën e rasteve kjo tarifë nuk aplikohet, mirëpo, ata kanë të drejtë të kërkojnë këtë tarifë sepse kjo krijon kosto shtesë, për konsumatorët që nuk mund të mbulojnë shpenzimet e energjisë elektrike, janë kategoritë e caktuara të cilat mbështeten nga institucionet adekuate.

Kryetari, paraqiti tre kërkesa, për të cilat kërkoi përgjigje me shkrim, lidhur me procesin kthimit të borxheve nga proceset nëpër gjykata; kërkoi një informatë rreth kolapsit rajonal energjetik të para pak ditësh, cili është opinioni i juaj; pyeti rreth fillimit të monitorimit të Ujmanit, a mund ta kemi vendimin dhe informacione rreth këtij monitorimi që erdhi si kërkesë nga KOSTT-i.

Ymer Fejzullahu, kryesues i Bordit të ZREE-së, tha në lidhje me kthimin e mjeteve, ne kemi obliguar KEDS-in që konform vendimeve të gjykatave të bëjnë kthimin e mjeteve tek konsumatorët, ende nuk ka filluar kthimi i mjeteve, por është dashur nga muaji qershor të fillojnë këto kthime. Në lidhje me pyetjen tuaj rreth kolapsit energjetik rajonal, fatmirësisht Kosova ka ndihmuar shtete e regjionit, ka qenë shtytësja kryesore për rikthimin e sistemit. Sa i përket monitorimit të Ujmanit, drafti është hartuar nga stafi dhe përvojat e mëhershme janë që këto monitorime zgjasin, nga përvoja e kaluar, besoj se ky monitorim do të zgjasë së paku 1 vit.

Pas debatit, kryetari konstatoi, se presim raportet me rekomandime të Komisionit për Buxhet dhe Komisionit për Financa Publike, mandej e procedojmë në seancë rezolutën, siç parashihet me ligj dhe rregullore.

7. Të ndryshme **Çështjet vijuese**

Mbledhja përfundoi në orën 14:00.

E përgatiti: Stafi mbështetës i Komisionit.

Ferat Shala,

Kryetar i Komisionit